

Rishikimi madhor i Llogarive Kombëtare, 2024

Instituti i Statistikave (INSTAT) si prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor në Shqipëri, njofton përdoruesit e statistikave zyrtare mbi rishikimin madhor (benchmark) të Llogarive Kombëtare, i cili do të kryhet në Shtator 2024.

Në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Politikën e Harmonizuar Evropiane për Rishikimin e Statistikave Makroekonomike (HERP – eng, link: [Data revision - ESA 2010 - Eurostat \(europa.eu\)](https://data-revision.esa.europa.eu)), rishikimet madhore janë procese të rregullta të sistemit të Llogarive Kombëtare, të cilat kryhen të paktën një herë në pesë vjet, në mënyrë të koordinuar dhe në bashkëpunim me Eurostat. Rishikimet kanë si qëllim përfshirjen e burimeve të reja të informacionit, përmirësimin e burimeve ekzistuese si dhe ndryshimet në metodologjinë statistikore ndërkombëtare.

Rishikimi i mëparshëm madhor i Llogarive Kombëtare të Republikës së Shqipërisë u krye në vitin 2014, kur INSTAT për herë të parë u bë pjesë e ciklit të rishikimit të standardeve të BE-së. Rishikimi i vitit 2024 do të jetë rishikimi i dytë i Llogarive Kombëtare.

Rishikimi i vitit 2024 do të konsistojë në:

- Përmirësime metodologjike në përputhje me standartet statistikore ndërkombëtare, të realizuara pas vitit 2014, nën asistencën e Bashkimit Evropian, nëpërmjet projekteve IPA Shumë përfituese dhe Eurostat në fushën e Llogarive Kombëtare;
- Përmirësim të afateve kohore të përpunimit dhe publikimit të të dhënave si pasojë e burimeve të përmirësuara të të dhënave;
- Përmirësim të treguesve statistikorë me synim rritjen e gjithpërfshitjes në vlerësimet e Llogarive Kombëtare si pasojë e përmirësimit të metodave statistikore;
- Rritje e plotshmërisë së treguesve dhe tabelave të publikuara në faqen zyrtare dhe të transmetuara në Eurostat;
- Rritje të cilësisë, nivelit të krahasueshmësisë dhe përputhshmërisë së treguesve statistikorë.

Ky rishikim do të përfaqësojë një hap tjetër të rëndësishëm përpara në procesin e harmonizimit të statistikave zyrtare të Shqipërisë me rregulloret dhe standardet e BE-së në fushën e Llogarive Kombëtare dhe do të mbikëqyret dhe verifikohet nga Eurostat.

Të dhënat e rishikuara për Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) dhe treguesit e tjerë makroekonomikë të sistemit të Llogarive Kombëtare, për vitin 2023, do të publikohen në dinamikë të rregullt sipas kalendarit të publikimeve të INSTAT, së bashku me serinë përkatëse të të dhënave të rillogaritura për periudhën 1995 - 2022.
